



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**ZL Anr.147/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Afijete Sada-Gllogjani dhe Ymer Hoxha anëtar, si dhe me pjesmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetevendosje (LVV), dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterit në hapsirë publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

### **V E N D I M**

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa ZL.Anr.147/2017 e datës 09.10.2017, e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë subjektit politik Lëvizja Vetevendosje (LVV), dega në Prizren, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

### **A r s y e t i m**

Me datën 09.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren, me të cilën pretendon se subjekti politik LVV ka vendosur pano reklamuese në objektin privat në lagjen e Kurillës pa pëlqimin e pronarit si dhe afër institucioneve publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 10.10.2017, subjekti politik, thekson se ankesa është e pa bazuar për arsye se panoja e kandidatit për anëtar të kuvendit komunal nga subjekti politik LVV, është e vendosur me leje të pronarit. Gjithashtu ka theksuar se pronari ka dhënë pëlqimin për vendosjen e panos me dt. 30.09.2017 dhe nga ajo ditë panoja është vendosur në përputhje me vullnetin dhe pëlqimin e pronarit të atij objekti. Prandaj kandidati për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e subjektit politik LVV nuk ka shkelur nenin 33 paragrafi 1 pika b).

Si dëshmi ka bashkangjitur pëlqimin-lejen e datës 30.09.2017.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

## **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politik LVV, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 33 pika b) të LZP-së, për arsye se vendosja e panove në objektin privat është bërë me pëlqimin paraprak të pronarit të objektit të dhënë me shkrim me datë 30.09.2017.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
ZL.Anr.147/2017 më datën 12.10.2017.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.